



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 62 Prot.

Tiranë, më 23/01/2017

Lënda : Dërgohen rekomandime për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Drejtuar : **Z. Fatmir XHAFAJ**
Kryetari i Komisionit
Komisioni Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KUVENDI I SHQIPËRISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit !

Në vijim të kërkesës së Komisionit Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë vijon disa rekomandime në lidhje me projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Së pari: Në mënyrë të përsëritur gjatë vitit 2013, 2014, kemi dërguar rekomandime për ndryshime në dispozitat e Kodit Penal, të cilat synonin mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Këto rekomandime njëkohësisht synonin të adresonin edhe angazhimet e marra nga shteti shqiptar në kuadër të Rekomandimit CM/Rek (2010)5 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, të miratuar nga Komiteti i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të. Duke i vlerësuar si të rëndësishme ndryshimet e rekomanduara, po Ju ridërgojmë propozimet, të cilat nuk kanë gjetur pasqyrim në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal gjatë ndryshimeve të mëparshme që ka pësuar ky kod. Këto rekomandime konsistojnë në sa më poshtë vijon:



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- a) Për të adresuar parashikimet e bëra në Rekomandimin CM/Rec (2010) dhe për të garantuar të drejtën për siguri dhe mbrojtje nga dhuna të personave për shkak të orinetimit seksual apo identitetit gjinor të tyre, propozojmë që : **pas nenit 84/a të Kodit Penal, të shtohet një nen tjetër me qëllim parashikimin si figurë të veçantë vepre penale të kanosjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.**
- b) Për të adresuar parashikimet që bëhen në pjesën e I-rë të Rekomandimit CM/Rec (2010), gërma “B” *“Fjalimet e urrejtjes”*, ku parashikohet se : *“Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikëve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin”*, propozojmë që : **të riformulohen ose të shtohen nene të reja pas nenit 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik” dhe nenit 119/b “Fyerja me motive racizmi ose ksenofomie nëpërmjet sistemit kompjuterik” në mënyrë që të kriminalizohet shpërndarja e materialeve homofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerja nëpërmjet sistemit kompjuterik për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personit.** Ekspertët e BE-së kanë theksuar gjithashtu nevojën e kryerjes së këtyre ndryshimeve dhe kanë rekomanduar që realizimi i tyre të përfshihet në Udhëzuesin për Prioritetin 5.
- c) Ashtu siç kemi theksuar dhe më lart Rekomandimi, kërkon me forcën ndalimin dhe dënimin publikisht të *“gjuhës së urrejtjes”* për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* e parashikon në nenin 1 të tij, **identitetin gjinor** si shkak të mbrojtur për të cilin ofron mbrojtje. Në ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal në vitin 2013, dhe konkretisht ndryshimet në nenin 265, ky nen është riformuluar duke kriminalizuar nxitjen e urrejtjes dhe grindjeve vetëm për shkak të orientimit seksual, duke përfshirë këtu identitetin gjinor. **Propozojmë që neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, të riformulohet për të kriminalizuar edhe nxitjen e urrejtjes për shkak të identitetit gjinor.**
- d) **Rekomandojmë gjithashtu heqjen e termit “marrëdhënie homoseksuale”** që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

Homoseksualizmi është dekriminalizuar në vitin 2001, me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal, sipas Ligjit Nr. 8733, datë 24.01.2001. Por, paralelisht me këtë ligj është shtuar në përmbajtjet e neneve 100, 101, 103, 104, 105, 106 dhe 107 të Kodit Penal shprehja “marrëdhënie homoseksuale”, si dhe është shtuar neni 102/a “*Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur*”.

Termi “Marrëdhënie seksuale” përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të të njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye, marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet këtyre veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtjen e neneve të mësipërme termin “marrëdhënie homoseksuale”.

Sa më sipër me qëllim eliminimin e përdorimit të një gjuhe të papërshtatshme, me konotacion negativ dhe paragjykses, rekomandojmë:

- a) Të hiqen nga titulli i nenit 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107 të Kodit Penal fjalët “ose homoseksuale;
- b) Të hiqen nga paragrafi i parë dhe i dytë i neneve 100, 101, 103 të Kodit Penal si dhe nga neni 104, 105, 106 dhe 107 të Kodit Penal fjalët “ose homoseksuale”;
- c) Riformulimin e nenit 102 të Kodit Penal me këtë përmbajtje :

“Marrëdhënie seksuale me dhunë me persona të rritur

Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me persona të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit/ës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit/ës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”

- e) Me riformulimin sa më sipër të nenit 102 të Kodit Penal, parashikimet që bën neni 102/a të Kodit Penal përfshihen në nenin 102 të riformuluar, prandaj rekomandojmë **shfuqizimin e nenit 102/a të Kodit Penal.**



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Së dyti: Nga përmbajtja e projektligjit, rezulton se nuk është marrë asnjë nismë për rishikim të neneve të Kodit Penal, të cilat synojnë eliminimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara. Nevoja për rishikimin e kodit, me qëllim eliminimin e parashikimeve diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, vjen edhe si rrjedhojë e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, (KDPAK) e cila tashmë është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012. Nevoja për përditësimin e gjuhës është një hap i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e shoqërisë për aftësitë e personave me aftësi të kufizuara. Kjo është rrjedhojë edhe e parashikimeve që ben Konventa Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për ndërgjegjësimin në nenin 8. Pra, termat e përdorur për përshkrimin e personave me aftësi të kufizuara duhet të harmonizohen me KDPAK dhe standartet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Përditësimi i termave duhet të jetë në përputhje me modelin bio-psiko-social që parashikon konventa.

Në këtë aspekt nga një vlerësim i Kodit Penal me KDPAK, rezulton se ka nevojë për një rishikim të termave të përdorura për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të kemi një unifikim të termave dhe përafrim me termat e përdorura nga Konventa. Kështu, mund të përmendim:

- nenin 17, të Kodit Penal “*Papërgjegjshmëria për shkak të gjëndjes mendore*”, ku terminologjia e përdorur nuk është në përputhje me modelin bio-psiko-social të Konventës;
- nenin 103, “*Marrëdhënie seksuale dhe homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur*”, ku termi “*pazotësi mendore*” duhet të jetë konform KDPAK;
- nenin 114/a, “*Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese*”, ku termi “*paafhtësi mendore*”, ka nevojë për harmonizim me konceptet moderne. Për sa i përket dhunës ndaj personave me aftësi të kufizuara, ky është një aspekt shumë i rëndësishëm dhe mundësisht duhet të përforcohet.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al